

**V E N D I M**  
**Nr. 432, datë 17.6.1996**

**PËR ZBATIMIN E MASAVE VETERINARE EMERGJENTE PËR IZOLIMIN DHE  
ÇRRËNJOSJEN E INFEKSIONIT VIRUSAL-AFTA EPIZOOTIKE**

Në zbatim të ligjit nr.7674, datë 23.2.1993 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, për të penguar përhapjen e mëtejshme dhe për të izoluar e çrrënjësuar sëmundjen virusale të gjedhëve në rrethet Korçë, Pogradec etj., me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Të shpallet karantina shtetërore në vatrat me infeksion viral afta epizootike të Prefekturës së Korçës, si dhe në rrethet ku eventualisht do të identifikohet sëmundja.
  2. Të theren e groposen gjithë krerët e vatrave të prekura, siç vendos komisioni teknik, si dhe të vaksinohen të gjitha kafshët dythundrake brenda territoreve të rekomanduara nga Misioni Veterinar i BEFMD/FAO.
  3. Të dërgohen në qendrat ndërkombëtare të referencës materiale patologjike dhe specialistët përkatës për të realizuar identifikimin dhe tipizimin e shkaktarit të infeksionit.
  4. Për zbatimin e masave karantinore, krahas strukturave shtetërore veterinarë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të marrin pjesë edhe organet e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe organet e pushtetit lokal të Prefekturës së Korçës.
  5. Vlera e vaksinës dhe pajisjeve për vaksinimin e konservimin e saj mbulohet nga buxheti i BEFMD/Fao dhe pa taksë doganore.
  6. Kontigjentet e mishit në transport e sipër drejt Shqipërisë nga vendet që nuk përfshihen në listën e BE, të rlejohen për t’u futur në territorin shqiptar gjër më 30 qershor të këtij viti. Sasitë gjendje të mishit të importuar nga vendet që nuk përfshihen në listat e BE, të përdoren sipas kushteve që do të vendosë Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
  7. Për mbulimin e shpenzimeve në zbatim të këtij vendimi caktohen 20 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i parashikuar për vitin 1996.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**